



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

07 Nr. 320-21130/23

Klinë, me 27.06, 2023

Projekti komunal për përkrahjen në zhvillimin e kulturave të perimtarisë (furnizim me sera 32 m²).

Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të bujqësisë- kulturës se perimtarisë, Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, bën :

THIRRJE PUBLIKE

Fton fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin e ngritjes se serave në sipërfaqe prej 32 m².

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në këtë projekt do të kontribuoj :

- Me 70 % të kostos se seres, ndërsa fermeri me 30 %; dhe
- Dhënien e këshillave profesionale, përmes eksperteve të saj.

Kriteret e konkurrimit:

1. Fermeri duhet të jetë banor i Komunës se Klinës;
2. Të posedoj sipërfaqe të mjaftueshme të tokës për vendosjen e serës. Toka duhet të jetë në emër të aplikuesit apo ndonjërit nga familjaret e ngushtë apo të këtë kontratë të vërtetuar nga noteri për shfrytëzimin e saj;
3. Të këtë mundësi ujitje (posedon bunar);
4. Të jetë i gatshëm që të marrë pjesë me 30 % të mjeteve financiare në koston e serës;
5. Përparësi do të kenë fermerët nga zonat rural, dhe ata të cilët nuk kanë përfituar asnjëherë nga projektet e Komunës - DBPZHR.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa e plotësuar nga fermeri, e cila merret në zyrën pritëse në hyrje të objektit të Komunës;
2. Fleta poseduese;
3. Certifikata e vendbanimit;
4. Kopja e letërnjoftimi;
5. Vërtetimi i tatimit në pronë.

Afati i aplikimit, është nga data 27.06.2023, deri me dt. 07.07.2023. Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Vërejtje: Nëse të dhënat e deklaruara në kërkesën për aplikim nuk përputhen, me gjendjen faktike të vërtetuar në teren nga komisioni, aplikuesi do të sanksionohet me minues 10 pikë.

Drejtori i Drejtorisë së BPZHR
Lorenc Marleku

